



Crna Gora / Mali i Zi
Opština Ulcinj
Komuna e Ulqinit
Kabinet Predsjednika
Kabineti i Kryetarit

Br./Nr. 01-040/24-1696/3



Crna Gora - Mali i Zi
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Priloge	Priloge	12.12.2024	
02-040/24-	591	11	

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi
tel: +382 30 412 050
e-mail: kabinet@ul-gov.me

Ulcinj/Ulqin, 10.12.2024.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT- SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
Kryetares së Kuvendit/ Predsjednici Skupštine

KËTU/OVDJE

E nderuara/ Poštovna,

Në bazë nenit 58 paragrafi 1 alinea 2 Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 – Vendimi i GjK MZ i 85/2022 – përmirësimi i Vendimit GjK MZ) dhe nenit 65 të Statutit të Komunës ("Fleta zyrtare e MZ – Regloret komunale", br. 48/2019 i 5/2024), në shtojcë ju dërgojmë Vendimin për emrimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit në Kuvendin e OT - Ulqin, në veprim të mëtejshëm.

Na osnovu člana 58 stav 1 aline 2 Zakona o lokalnoj samoupravi ("Službeni list CG", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 - Odluka US CG i 85/2022 - ispravka Odluke US CG) 65 Statuta Opštine ("Službeni list CG – Opštinski propisi", br. 48/2019 i 5/2024), u prilogu Vam dostavljamo, Odluku o imenovanju predstavnika Skupštine Opštine Ulcinj u Skupštini TO - Ulcinj, na dalje postupanje.

Me rrespekt/ S poštovanjem,

Kryetari/Predsjednik

Genci Nimanbegu



Genci Nimanbegu

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1 pika 2, në lidhje me nenin 59 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22 dhe 85/22), nenit 58 paragrafi 1 pika 44, në lidhje me nenin 113 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi – Regulloret komunale", nr. 48/19 dhe 5/24), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur më .2024., solli

VENDIMIN

për vërtetimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës nr. 01-040/24-1696/1 të datës 18.11.2024

Neni 1

Vërtetohet Vendimi i Kryetarit të Komunës nr. 01-040/24-1696/1 i datës 18.11.2024 për emrimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit në Kuvendin e OT- Ulqin.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe Vendimi i Kryetarit të Komunës nga neni 1.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale".

Numër: 02-
Ulqin, .2024

**KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
KRYETARJA**

ARSYETIMI

BAZA LIGJORE

Baza ligjore për marrjen e këtij vendimi gjendet në nenin 38 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili parasheh se Kuvendi miraton rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme, në nenin 59 të të njëjtit ligj, i cili parasheh se kryetari i Komunës përkohësisht i miraton aktet në kompetencë të Kuvendit nëse Kuvendi nuk mund të mbledhet ose pengohet puna e tij për arsye të tjera, e nëse nuk miratohen do të rrezikohet jeta e qytetarëve ose prona me vlerë më të madhe, që kryetari është i obliguar që aktin nga paragrafi 1 i këtij neni t'ia dorëzojë Kuvendit për konfirmim në seancën e parë pasuese, dhe nëse kuvendi nuk e konfirmon aktin nga paragrafi 1 i këtij neni ose nëse kryetari nuk e dorëzon, për konfirmim, ai akt pushon së vlefshmi brenda tre muajve nga data e miratimit. Po ashtu, neni 58 paragrafi 1 pika 2 e Statutit të Komunës së Ulqinit parasheh që kuvendi miraton rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme.

ARSYET E NJË VENDIMIT TË TILL

Arsyet për marrjen e këtij vendimi përmbahen në nevojën e konfirmimit të Vendimit për emrimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit në Kuvendin e OT- Ulqin, me nr 01-040/24-1696/1 nga 18.11.2024. e cila është miratuar nga kryetari i Komunës së Ulqinit në pajtim me kompetencat e parapara në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

PËRMBAJTJA E VENDIMIT

Neni 1 përcakton se kush do të jetë pjesë e Kuvendit të organizatës turistike e si përfaqësues të Kuvendit të Komunës.

Në nenin 2 përcaktohet që hynë në fuqi ditën e publikimit në fletën zyrtare, e kjo për arsye të emergjencës dhe që me hyrje në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i mëparshëm nr. 02-016/23-573/26, datë 29.12.2023.

Për arsyet e lartpërmendura, sugjerohet që Kuvendi i Komunës së Ulqinit të miratojë Vendim për emrimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit në Kuvendin e OT- Ulqin.

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për organizatat turistike („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“ nr. 11/04, 46/07, 40/11, 45/14, 42/17 dhe 27/19), nenit 12 të Vendimit për themelimin e Organizatës Turistike të Komunës Ulqin („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Aktet komunale“ nr. 05/07 dhe 4/23), nenit 19 të Statutit të Organizatës Turistike (OT-Ulqin) nr. 01-83/1-11, datë 21.03.2011 dhe nenit 110, paragrafi 1, alinea 28 të Statutit të Komunës Ulqin („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Aktet komunale“ nr. 48/19 dhe 5/24), Kryetari i Komunës, më datë 18.11.2024, sollë:

VENDIMIN

për emërimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës Ulqin në Kuvendin e OT-Ulqin

Neni 1

Në Kuvendin e OT-Ulqin emërohen anëtarët e mëposhtëm:

1. Genci Nimanbegu – kryetar;
2. Ivana Popović Jančić;
3. Beqir Sellaj;
4. Petar Delić;
5. Qemal Bajri;
6. Mirjeta Gjoni;
7. Arijan Ljamović;
8. Shkelzen Sulejmani;
9. Leart Taipi;
10. Amir Mehmeti;
11. Arbin Çapriq;
12. Ahmet Aloshi;
13. Minir Karamanaga;
14. Avdulah Nimanbegu;
15. Naser Resulbegu;
16. Mehmed Milla;
17. Merita Subašić Shabanović;
18. Artan Muçaj;
19. Enisa Martinović;
20. Senad Kollari;
21. Arsim Cuca;
22. Adriana Hoxha;
23. Ajet Zaga;
24. Shpetim Jahja.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në „Fletën Zyrtare e Malit të Zi – Aktet komunale“. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i mëparshëm nr. 02-016/23-573/26, datë 29.12.2023

Kryetari i Komunës së Ulqinit
Genci Nimanbegu

ARSYETIMI

BAZA LIGJORE

Baza ligjore për miratimin e kësaj vendimi është përfshirë në nenin 38, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, i cili përcakton se Kuvendi miraton akte dhe dispozita të tjera të përgjithshme; në nenin 59 të të njëjtit ligj, i cili përcakton se kryetari i Komunës miraton përkohësisht aktet nga kompetenca e Kuvendit nëse Kuvendi nuk është në gjendje të mbledhet ose nëse puna e tij është penguar për arsye të tjera, dhe mosmiratimi i tyre mund të rrezikojë jetën e qytetarëve ose pronën me vlerë më të madhe; se kryetari është i detyruar të paraqesë aktin nga paragrafi 1 i këtij neni për konfirmim në Kuvend në mbledhjen e parë të radhës; dhe se, nëse Kuvendi nuk e konfirmon aktin nga paragrafi 1 i këtij neni ose nëse kryetari nuk e paraqet për konfirmim, ai akt pushon së vlefshmi brenda tre muajve nga dita e miratimit. Gjithashtu, në nenin 58, paragrafi 1, pika 44 të Statutit të Komunës Ulqin, është përcaktuar se Kuvendi rregullon orarin e punës së objekteve hotelierike, tregtare dhe zejtare dhe përcakton zonat ku mund të ushtrohet një veprimtari e caktuar në përputhje me ligjin.

ARSYET E MARRJES SË TI VENDIMIT

Arsyeja për miratimin e Vendimit për emërimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës Ulqin në Kuvendin e Organizatës Turistike – Ulqin lidhet me faktin se kryetari i Komunës është njëkohësisht edhe kryetar i Organizatës Turistike dhe se kryetari i Komunës propozon anëtarët e Kuvendit të Organizatës Turistike.

Duke pasur parasysh se është fundi i vitit, se Kuvendet në këtë periudhë kanë shumë aktivitete dhe se anëtarët duhet të angazhohen në mënyrë aktive në punën e Kuvendit, e kam konsideruar të arsyeshme të miratoj këtë vendim me qëllim të parandalimit të pasojave të mundshme, duke e dërguar atë më pas në Kuvend për konfirmim.